

SHQIPËRIA DHE EURO

*Gramoz Kolasi**

Fjalë kyçe

- Euro - Eurozonë - Fushatë informimi - Fushatë sensibilizimi - Edukim i publikut -

Afrimi i fundvitit 2001, përkon me një ngjarje tejet të veçantë për botën e financave dhe të biznesit: me “daljen në dritë” të Euros si një para fizike. Në të vërtetë përmasat e këtij evenimenti janë realisht të mëdha, kur sjell ndërmend se formacionet ekonomike dhe shoqërore, që janë të lidhura dhe të interesuara për të, janë po aq të mëdha si për nga numri ashtu dhe për nga shtrirja gjeografike.

Njësimi monetar i Evropës së Bashkuar, i arritur që në fillimin e vitit 1999, duke filluar që nga një janari i vitit 2002, do të shënojë një zhvillim të ri, duke u bërë një realitet i dukshëm dhe i prekshëm nga kushdo. Duket se ka ardhur momenti i përshtatshëm për të filluar edukimin dhe familjarizimin e vetvetes me këtë fenomen të ri në pritje. Nuk kemi pse të çuditemi nga reduktimi i shportës së monedhave të huaja në vetëm dy – tre monedha kryesore ose më saktë nuk duhet të na zërë paniku kur në vend të fjalëve doçmarka, lireta apo dhrahmi do të dëgjojmë një fjalë të vetme Euro.

Nga këndvështrimi i këtij artikulli dhe nga interesat praktikë të publikut të gjerë duket se nuk është shumë i rëndësishëm rikthimi mbrapa në histori. Megjithatë, qoftë dhe thjesht për kuriozitet, do të ishte me interes përmendja e dy – tre momenteve kryesore

që çuan në lindjen e monedhës së Evropës së Bashkuar, për t'i lënë vendin më tej sqarimit të shumë momenteve praktike që kanë të bëjnë me "look-un" e saj, me rëndësinë që ka kjo ngjarje për Shqipërinë, me masat që do të ndërmarrë Banka e Shqipërisë etj..

PAK HISTORI

Hapi i parë politik për krijimin e Evropës së Bashkuar përkon me Traktatin e Romës në vitin 1957, ku udhëheqësit e vendeve të Evropës ranë dakord për krijimin e Tregut të Përbashkët Evropian me qëllim kryesor rritjen e mirëqenies ekonomike dhe krijimin e një bashkimi shumë të ngushtë midis popujve të Evropës. Ndërkohë që, me kalimin e viteve shtoj bashkëpunimi dhe iniciativat e përbashkëta evropiane, sidomos në fushën politike, vendimet e mirëfillta që i paraprinë bashkimit ekonomik dhe monetar të BE-së, arrijnë diçka më vonë, fillimisht në vitin 1986 nëpërmjet Aktit Unik mbi Evropën (1986) dhe më vonë në vitin 1992, me anë të Traktatit të Bashkimit Evropian. Zhvillimi më i rëndësishëm përkon me 1 janarin e vitit 1999, kur filloi dhe e ashtuquajtura faza e tretë e bashkimit monetar. Më konkretisht, u vendos që politika monetare e vendeve të Zonës së Euros të ishte e përbashkët dhe që nga ai moment Euro u pranua si monedha e përbashkët në llogari. Konvertimi i monedhave pjesëmarrëse në Euro me njëra – tjetrën do të bëhej sipas raporteve të fiksuara dhe që nga ai moment, monedhat kombëtare të 11 vendeve pjesëmarrëse u bënë thjesht shprehje kombëtare.

Më 1 janar 2001 numri i vendeve të Eurozonës shtohet me një anëtar të ri që ishte Greqia, duke çuar numrin e vendeve anëtare në 12.

KARTËMONEDHAT E REJA. SI DO TË JENË ATO.

Ndoshta jo që nga data 1 janar 2002, por me siguri që në ditët në vijim çdokush do të ketë mundësinë që të zotërojë një bankënotë të quajtur Euro. E çfarë prerjeje mund të jetë ajo, cilat janë karakteristikat e përbashkëta dhe kush është

domethënia e simboleve dhe e figurave të stampuara në kartëmonedhë?

Këto janë pyetje të natyrshme që mund të lindin që në momentin e parë. Ky kuriozitet intuitiv bëhet akoma më i madh kur dihet që deri sot Euro është një monedhë në llogari dhe perceptimi i individëve për këtë formë të parasë është i vështirë për aq kohë sa ajo nuk preket dhe nuk mbahet në portofol.

Dizenjatorët e kartëmonedhave dhe të monedhave Euro, janë përpjekur të ruajnë një ekuilibër midis identitetit të çdo vendi anëtar me simbolikën e përdorur për të treguar bashkimin e tyre. E gjithë seria e monedhave¹ përbëhet nga 8 prerje të ndryshme: 1, 2, 5, 10, 20 dhe 50 cent si dhe 1 dhe 2 euro. Të tetë llojet e monedhave ndryshojnë në madhësi, në peshë, në trashësi dhe në materialin që i përbën ato.

Në dizenjimin e monedhave është rënë dakord që faqja e përparme të jetë e njëjtë për të gjitha vendet anëtare, ndërsa faqja e mbrapme të jetë kombëtare ose e thënë ndryshe të pasqyrojë simbolikat kombëtare² të çdo vendi anëtar. Pavarësisht faktit se faqja e mbrapme do të ndryshojë nga njëri vend në tjetrin, të gjitha monedhat do të jenë mjete zyrtare pagese në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Ndryshe nga monedhat, prerjet e kartëmonedhave do të kenë të njëjtin "look" në të gjitha shtetet anëtare. E gjithë seria e tyre përbëhet nga 7 prerje: 5, 10, 20, 50, 100, 200 dhe 500 euro. Kartëmonedhat Euro janë dizenuar nga artisti austriak Robert Kalina, i cili është frymëzuar nga tema "Epokat dhe Stilet Evropiane". Janë zgjedhur stile arkitektonike tipike të shtatë periudhave të historisë dhe të kulturës evropiane: arti klasik për prerjen 5 euro; arti romantik për prerjen 10 euro; arti gotik për prerjen 20 euro; arti i rilindjes për prerjen 50 euro; baroku dhe rokoko për prerjen 100 euro; arkitektura e hekurit dhe e qelqit për prerjen 200 euro dhe arkitektura e shekullit 20 për prerjen 500 euro. Elementet arkitektonike reflektojnë stilin tipik të çdo epoke dhe nuk përfaqësojnë monumente reale.

Në elementet e përbashkëta, që janë vendosur në çdo prerje, veçojmë flamurin evropian, 12 yjet e BE-së, pesë shkurtimet³ për Bankën Qendrore Evropiane, si dhe shkrimi në latinisht dhe greqisht i fjalës EURO. Përveç simboleve të njohura të BE-së, në serinë e kartëmonedhave gjejmë pasqyrim dhe elemente të tjera me simbolika të caktuara si prania e një ure në faqen e prapme, e cila nënkupton bashkëpunimin midis vetë popujve të Evropës dhe më gjerë, prania e portave në faqen e përparme, që simbolizon shpirtin evropian të hapur dhe të gatshëm për bashkëpunim etj..

Në përfundim, duhet thënë se madhësia dhe ngjyrat e çdo prerjeje janë të ndryshme për të lehtësuar identifikimin e tyre. Sa më e madhe të jetë vlefja e biletës që zotëron aq më e madhe është edhe ajo vetë. Nga ana tjetër, janë marrë masat për t'i ardhur në ndihmë edhe personave të verbër, për të cilët janë vendosur shenja dalluese të veçanta.

Për të shuar më tej kuriozitetin është vendosur që në datën 1 janar 2002, të jenë në dispozicion 1 4545 milionë kartëmonedha, të cilat do të jenë të shpërndara sipas shteteve dhe prerjeve.

Kurioziteti i mëtejshëm në lidhje me monedhën e përbashkët mund të vazhdojë të shuhet me detaje më të hollësishme, që kanë të bëjnë me elementet e sigurisë, me teknikat e printimit etj.. Megjithatë, edhe për shpjegime më të detajuara është menduar, por duhet thënë se momentalisht individët, agjentët ekonomikë në përgjithësi janë më shumë të interesuar për atë se si do të ngjajnë ato dhe çfarë masash po merren nga autoritetet në Shqipëri, në mënyrë që lançimi i monedhës së re të përjetohet sa më natyrshëm.

EURO DHE EKONOMIA SHQIPTARE

Tashmë nuk përbën ndonjë të re fakti, që pjesa më e madhe tregtisë së jashtme zhvillohet me vendet e Eurozonës, ashtu sikurse dhe pjesa më e madhe e ndihmave financiare dhe e kredive, që i janë akorduar Shqipërisë nga BE-ja, janë në Euro. Po kështu dhe të hyrat valutore nga emigracioni, për aq kohë sa dërguesit e tyre, në pjesën më të madhe janë të vendosur në

Greqi, Itali dhe Gjermani, janë të shprehura në Euro. Në këtë kuptim, megjithë “një simpati” të shqiptarëve ndaj monedhës amerikane, siç vihet re, një pjesë e mirë e hyrjeve valutore është e shprehur në Euro.

Në këtë mënyrë, ekonomia e vendit tonë është e përballur me një lloj rreziku, që ka të bëjë me ecurinë e këmbimit të monedhës evropiane me monedhat e tjera të huaja ashtu sikurse dhe me vetë Lekun Shqiptar. Një ulje e vlerës së monedhës evropiane në raport me Lekun do të bënte që, për një njësi import malli, tregtari shqiptar të paguajë më pak lekë, e për rrjedhim edhe presioni i çmimeve të importit mbi zhvillimet e brendshme do të ishte më i zbutur.

Anasjelltas, në qoftë se tregtarit shqiptar do t’i duhej që për një njësi Euroje të paguajë më shumë se një ditë më parë kuptohet, që ai do të korrigjojë të gjitha çmimet e shitjes në lekë, me tendencën për t’i rritur ato.

Përveç implikimeve makro, lançimi i Euros mund të shoqërohet dhe me forma të ndryshme paniku. Një pjesë e mirë e pasurisë së shqiptarëve në formën e likuiditetit (në llogari bankare apo në shtëpi) mbahet në Euro. Megjithëse dollari amerikan vlerësohet të jetë i preferuar për thesarizimin e pasurisë, përsëri ekziston dhe alternativa tjetër, ajo e ruajtjes së tyre në nënfisha⁴ të Euros. Nga ana tjetër, për shkak të ekzistencës së ekonomisë joformale, mund të shfaqet rasti kur në duart e shumë individëve dhe agjentëve ekonomikë (biznesmenë, kambistë etj.) të jetë një sasi e caktuar markash, liretash etj.. Në këto rrethana nuk përjashtohet mundësia që, në një moment të caktuar, të ketë “dyndje” në sportele fenomen i cili në mungesë të një administrimi të ideuar që më parë mund të marrë përmasat e një paniku, pasojat e të cilit do të ndiheshin si mbi stabilitetin e sistemit financiar ashtu dhe mbi vetë ekonominë.

Megjithëse kanë kaluar rreth 2 vjet nga lançimi i Euros si para në llogari, akoma, nga shumica e individëve, parapëlqehet të thuhet se zotëron marka, lireta apo drahmi. Në të vërtetë, ata nuk e dinë se raportet e shkëmbimit të tyre me 1 euro janë

njëherë e mirë të fiksuar dhe nuk ka nevojë që të shkosh në treg dhe të pyesësh se sa është kursi i sotëm i këmbimit të drahmisë me euron. Kjo mungesë njohurish në shtresat e gjera të popullsisë mund të kthehet në faktor spekulimi, i cili duke u kombinuar me pasojat e mundshme, të shpjeguara më sipër, mund të marrë përmasa të mëdha.

Duke iu kthyer edhe një herë përfundimeve të arritura në paragrafët e mësipërm, do të evidentonim se, ndërsa rreziku i kursit të këmbimit më së shumti ka të bëjë me parimet bazë të makroekonomisë, implikimet e tjera kryesisht janë për shkaqe subjektive.

Për rrjedhim, shmangia e tyre është plotësisht e mundshme dhe për këtë qëllim Banka e Shqipërisë ka filluar përgatitjet me kohë.

ÇFARË KA PROGRAMUAR BANKA E SHQIPËRISË?

Periodha e mbetur deri në 1 janar 2002, nga ana e Bankës së Shqipërisë është konsideruar si një periudhë intensive e informimit dhe e edukimit të publikut, sidomos duke filluar që nga muaji shtator 2001. Në të vërtetë, plani i ideuar i masave përveç fushatës së informimit konsiston dhe në kryerjen e disa veprimeve operacionale që kanë të bëjnë me hedhjen në qarkullim të Euros.

Megjithatë, këto të fundit janë detaje më teknike, trajtimi i të cilave do të jetë pjesë e debatit mes bankierëve. Ajo çka është me interes është fushata e informimit të publikut, qëllimi i së cilës do të jetë krijimi i një ambienti sa më të përshtatshëm për pranimin sa më të natyrshëm të Euros nga realiteti shqiptar.

Në funksion të këtij qëllimi, Banka e Shqipërisë ka kuptuar se kjo fushatë informimi dhe edukimi e publikut do të jetë e dështuar nëse ajo (Banka) nuk do të arrijë të bashkëpunojë dhe ta ndajë këtë përgjegjësi me institucionet e tjera financiare në vend, me shoqatën e bankierëve dhe sidomos me median në përgjithësi. Është ky shkak që e ka shtyrë Bankën e Shqipërisë

që mbas mbarimit të fazës së parë⁵ (deri më 31 gusht 2001) të fillojë një fushatë propaganduese⁶ në lidhje pamjen, elementet e sigurisë, afatin e mbarimit ligjor të nënfishave të Euros etj..

Informacioni i bollshëm për karakteristikat e mësipërme të monedhës së re evropiane do të disponohet në të gjitha sportelet e sistemit bankar, në sportelet e agjencive valutore si dhe në sportelet e të gjitha institucioneve të tjera financiare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Për publikimin e këtij informacioni do të ftohen që të kontribuojnë si media e shkruar ashtu dhe ajo vizive.

Gjatë fazës së dytë, një vend të rëndësishëm do të zënë dhe seminarët e organizuara nga Banka e Shqipërisë, qëllimi i të cilave do të jetë sqarimi në detaje i çështjeve të trajtuara më sipër. Gjithashtu, për t'i shërbyer një auditori sa më të madh të interesuarish, Banka e Shqipërisë është e gatshme që të mbajë emisione të posaçme në median vizive.

Grupi i dytë i masave të parashikuara, ka një natyrë operacionale dhe synon të sigurojë:

- që më 1 janar 2001, Euro do të jetë e pranishme dhe në Shqipëri;
- se konvertimi i zotërimeve në valuta kombëtare të vendeve të Eurozonës me Euro do ta bëhet pa eksese;
- se do të garantohej mbajtja nën kontroll e spekulimeve të mundshme me kursin e këmbimit.

Për t'i paraprirë plotësimin të këtyre tre objektivave, Banka e Shqipërisë, gjykon se përveç veprimeve që do të kryejë për llogari të saj, ajo (Banka) do të kërkojë nga bankat e nivelit të dytë që të marrin masat për:

- sigurimin e fondeve të mjaftueshme në *cash*, në përputhje me zotërimet që ato kanë në nënfisha të Euros para datës 30 dhjetor;
- përgatitjen e një plani masash se si bankat do ta zgjidhin këtë problem.

Nga ana e saj Banka e Shqipërisë do të marrë të gjitha masat për sigurimin e rezervave të veta në *cash*, duke gjykuar mbi vëllimin dhe strukturën sipas prerjeve dhe për shmangien e spekulimeve të mundshme me kurset e këmbimit.

NË VEND TË MBYLLJES

Periudha e mbetur nuk duhet konsideruar mjaftueshmërisht e gjatë por nga ana tjetër, nuk duhet të na zërë dhe paniku. Fakte të tilla si për shembull, mosekzistenca e një vlerësimi të përafërt mbi shumën totale të zotërimeve në Euro që ambienti ekonomik dhe individët shqiptarë kanë në zotërim përbëjnë shqetësim por që gjithsesi, mund dhe duhen ezauruar. Nga ana tjetër, duhet pranuar që në fushatën e informimit të publikut, çdo palë duhet të bëjë pjesën e vet, e për rrjedhim edhe përgjegjësia për sensibilizimin dhe edukimin e publikut duhet parë si një përgjegjësi e ndarë më tresh, Banka e Shqipërisë, institucione financiare dhe media.

SHËNIME

* Gramoz Kolasi, Zëvendës drejtor i Departamentit të Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

Prezantim në seminarin “Hyrja në qarkullim dhe shpërndarja e Euros”.

¹ 1 euro është e barabartë me 100 cent.

² Belgjika, Luksemburgu, Holanda dhe Irlanda kanë vendosur vetëm një motiv, përkatësisht Mbreti Ludvig II, Duka i Madh Henri, Mbretëresha Beatrice, simboli kombëtar i harpës. Po kështu një motiv të vetëm kanë dhe monedhat e prera në Itali, Austri dhe Greqi.

Në monedhat e Gjermanisë, prerjet 1 dhe 2 euro, kanë shqiptonjën e Federatës, ndërkohë që monedhat 10, 20 dhe 50 cent kanë Portën e Bradenburgut. Në prerjet e vogla 1, 2 dhe 5 cent është vendosur një degë lisi. Ashtu si Gjermania edhe Franca, Spanja dhe Portugalia kanë përdorur tre motive të ndryshme.

³ EZB – BCE – ECB – EKT – EKP janë shkurtime të bazohen në 11 gjuhët zyrtare të BE-së.

⁴ Monedhat kombëtare të 12 vendeve të Eurozonës.

⁵ Gjatë kësaj faze është parashikuar të bëhen botime të ndryshme me karakter informativ si dhe të mbahen konsultime me shoqatën e bankierëve.

⁶ Kjo fushatë përkon dhe me fazën e dytë, që fillon nga data 1 shtator 2001 deri më 31 dhjetor 2001. Ndarja e fushatës në dy periudha ka lidhje me faktin se vetë Banka Qendrore Evropiane ka shpallur një intensifikim të fushatës së saj informuese dhe edukuese, duke nisur që nga shtatori 2001.

